

**MBI AKTIVITETIN
E KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR
DHE ZHVILLIMET NË REFORMËN
PËR MIRËQEVERISJEN, ANTIKORRUPSIONIN
DHE SUNDIMIN E LIGJIT**



**KPP – Buletin periodik 07
Dhjetor 2024**



**KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR
“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN
PËR SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**

12 dhjetor 2024

Mbahet takimi i nivelit të lartë “Shqipëria 2030 në BE – Rruga e reformave”

Kuvendi i Shqipërisë organizoi takimin e nivelit të lartë “Shqipëria 2030 në BE – Rruga e reformave”, ku morën pjesë Kryeministri Edi Rama, ambasadori i BE-së në Tiranë, z. Silvio Gonzato, e ngarkuara me punë e SHBA-ve, znj. Nancy Van Horn, ministra, përfaqësues të trupit diplomatik dhe të partnerëve ndërkombëtarë, anëtarë të Komisionit të Posaçëm për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit, deputetë, përfaqësues të institucioneve shtetërore, të agjencive ligjzbatuese dhe të shoqëria civile, ekspertë të nivelit të lartë dhe anëtarë të Sekretariatit Teknik të atashuar pranë Komisionit të Posaçëm etj.

Ky takim u zhvillua në mbyllje të fazës së parë të veprimtarisë së KPP-së: atë të procesit të hartimit të Dokumentit Analitik (analizës së bërë nga ekspertët e atashuar në tri shtyllat e Komisionit të Posaçëm) si dhe të zhvillimit me sukses të 11 tryezave tematike publike, konsultuese, ku morën pjesë rreth 600 pjesëmarrës nga të gjitha grupet e interesit dhe të shoqërisë civile.

Kryetarja e Kuvendit, znj. Elisa Spiropali, në fjalën e saj të hapjes së takimit theksoi rëndësinë e avancimit të mëtejshëm të reformave zhvillimore e demokratizuese, si kushte të domosdoshme për të përcaktuar përgjegjësitë për procesin transformues integruar të Shqipërisë. “Kuvendi do të vijojë të udhëheqë me vendosmëri procesin e anëtarësimit për të garantuar legjitimitetin demokratik dhe karakterin gjithëpërfshirës të procesit. Përballimi me sukses i sfidave të negociatave kërkon rritjen e rolit kontrollues të Kuvendit, posaçërisht të Komisionit për Çështjet Europiane dhe të Këshillit Kombëtar të Integritimit Europian gjatë procesit të negociatave për të garantuar përmbushjen e kriterëve të vendosura për hapjen dhe mbylljen e grupkapitujve, monitorimin e ecurisë së procesit në bashkëpunim me grupet e interesit, shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë jopolitikë si dhe informimin e publikut mbi ecurinë e negociatave”, – u shpreh znj. Spiropali.

Kryeministri, z. Edi Rama, në fjalën e tij tha se është përmbyllur një fazë shumë e rëndësishme, themelore për integrimin në BE dhe nënvizoi se Kuvendi është i vetmi institucion që ka të drejtën dhe detyrën për të garantuar që procesi i negociatave me BE-në të ecë me ritmin e duhur nga të gjitha institucionet e shtetit. “Puna e bërë dhe Dokumenti Analitik prej 700 faqesh janë pjesë e gjysmës së dytë të këtij viti, ndërkohë që gjysma e parë e vitit është konsumuar me frymën e skepticizmit të dyshimeve dhe kundërshtive, pa diskutim edhe të akuzave, por këto janë një element që nuk dua ta përfshij”, – theksoi Kryeministri Rama dhe më tej ai shtoi: “Pyetja që lind këtu është shumë e thjeshtë: cili është vendi dhe cili është institucioni në këtë Republikë që mund t'i mbledhë të gjithë rreth këtij misioni dhe që mund të sigurojë që qytetarët e Republikës së Shqipërisë, të cilëve iu shërbejnë të gjitha këto institucione, të jenë të garantuar se asnjë institucion nuk i tradhëton në pritshmërinë e tyre për ta parë Shqipërinë anëtare të BE-së? Ka vetëm një institucion që mund ta bëjë këtë, dhe ky institucion është Kuvendi i Shqipërisë, i cili, për natyrën e tij kushtetuese, është i

vetmi institucion që ka të drejtën dhe detyrën t'i thërrasë të gjithë, madje, në procesin e vet të natyrshëm, t'u kërkojë dhe llogari, të bëjë edhe rezoluta, të ngrejë dhe probleme, të nxjerrë dhe pretendime. Atëherë, ky është institucioni që mund të garantojë që procesi është i harmonizuar, procesi është transparent dhe ka edhe elementin llogaridhënës të të gjitha insitucioneve. Shqipëria është një republikë që ka tri pushtete të pavarura nga njëri-tjetri: legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin, por të tria këto pushtete kanë detyrimin të ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe pastaj në këtë proces duhet të udhëhiqen nga sensi i misionit kombëtar, të harmonizimit të të gjitha forcave për të arritur rezultatet.”

Në vijim të fjalës së tij Kryeministri theksoi përfshirjen e të gjithë ekspertëve, nga akademia, institucionet e pavarura, shoqëria civile dhe biznesi, në këtë proces. “Ne e kemi bërë zgjedhjen tonë, dhe ajo është: të vazhdojmë të thellojmë të gjitha reformat; të thellojmë dhe ta bëjmë të pakthyeshme ndarjen mes pushteteve; të thellojmë dhe ta bëjmë të pakthyeshme rrugën e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, që është një luftë e të gjithë shtetit, jo vetëm e një, dy apo tri institucioneve; të garantojmë pavarësinë dhe pakthyeshmërinë e pavarësisë së institucioneve të drejtësisë dhe ta futim Shqipërinë në Bashkimin Europian”, – shtoi Kryeministri Rama. Kryetari i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit, z. Fatmir Xhafaj, në fjalën e tij u ndal te puna e bërë për ndërtimin e një procesi reformimi shumë dimensional të mbështetur në 4 parime të kryesore: i) *gjithëpërfshirjen*; ii) *transparencën*; iii) *profesionalizmin*; iv) *standardet më të mira ndërkombëtare*. “Në këta 10 vjet Kuvendi për herë të dytë bëhet hapësira kushtetuese e institucionale dhe promotori për inicimin, organizimin dhe realizimin e dy reformave të mëdha shtetndërtuese: fillimisht me reformën në drejtësi, që nisi 10 vjet më parë dhe që sot është një realitet i prekshëm e më se i vlerësuar pozitivisht, dhe gjatë këtij viti me këtë reformë kaq komplekse, që synon tri sfida kryesore. Ky është një tregues shumë domethënës, që dëshmon pjekurinë e demokracisë sonë, është shprehje e përgjegjësisë dhe rolit reformator të Kuvendit edhe për shkak të peshës dhe funksioneve kushtetuese që mbart në republikën tonë parlamentare”, – u shpreh z. Xhafaj.

Në përfundim të fjalës së tij z. Xhafaj thaksoi: “Si edhe me reformën në drejtësi, ne jemi angazhuar të ndërtojmë një projekt që ka në themel guximin për të sfiduar statukuonë, vizionin afatgjatë, përkushtimin ndaj njerëzve dhe lidershipin për të drejtuar përpjekjet për transformime të reja shtetndërtuese në vendin tonë. Duke u përballur me këto sfida, që e bëjnë vendin tonë më të mirë, ne e bëjmë më të lehtë e më të shpejtë edhe rrugën tonë për Shqipërinë 2030 në BE. Kjo është nisma jonë, projekti ynë. Është përgjegjësia jonë përball qytetarëve tanë, në interes të fëmijëve tanë, së ardhmes së tyre europiane, domosdoshmërisë për të konsoliduar më tej demokracinë dhe shtetin e së drejtës.”

Ambasadori i Bashkimit Europian në Shqipëri, z. Silvio Gonzato, në fjalën e tij u shpreh se Shqipëria ka një mundësi historike dhe perspektiva e saj për t'u bërë anëtare e BE-së është reale. “Institucionet e BE-së do të përqendrojnë të gjitha energjitë e tyre për ta çuar përpara procesin sa më shpejt dhe në mënyrën më efikase që të jetë e mundur. Besoj se deri tani ne e kemi mbajtur premtimin. Sa i takon rritjes së ofertës sonë, shpejtësia me të cilën u miratua plani i reformave dhe

i rritjes është një sinjal i qartë i këtij angazhimi. Shqipëria ka një mundësi historike përpara. Perspektiva e vendit tuaj për t'u bërë anëtare e BE-së është reale. Institucionet shqiptare kanë përgjegjësinë historike për ta bërë realitet një gjë të tillë. Ato kanë përgjegjësinë të mobilizojnë të gjitha burimet politike dhe administrative për të ecur përpara në mënyrë vendimtare në vitet që do të vijnë, sepse tashmë gjërat po ecin përpara.”

Ministja e Shtetit dhe Kryenegociatorja e Shqipërisë me BE-në, znj. Majlinda Dhuka, në fjalën e saj tha se Shqipëria i çeli negociatat në bazë të njohjes së progresit në reformat europiane, me çelës reformën në drejtësi. Ministria e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni, u shpreh se Shqipëria është kthyer në një lider rajonal në fushën e reformës së administratës publike, e përqendruar tashmë në drejtim të organizimit të politikave, të forcimit të sistemit të menaxhimit financiar, por dhe në drejtim të ofrimit me efektivitet të shërbimeve digjitale.

Përfaqësuesja e shoqërisë civile, njëkohësisht anëtare e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë, znj. Eda Noçka, theksoi se analiza e bërë në të gjithë komponentët e tri shtyllave është një punë e pavarur thellësisht profesionale, e mbështetur mbi dokumente zyrtare të institucioneve ndërkombëtare dhe të organizatave prestigjioze që monitorojnë vendin tonë. Ajo e konsideroi këtë proces përfitues jo vetëm për thellimin e reformave në kuadër të procesit të integritetit europian dhe vetë vendit, por edhe për forcimin e shoqërisë civile dhe qytetarëve për të luajtur një rol më aktiv.

TRYEZA PUBLIKE TEMATIKE

Komisioni i Posaçëm vijon tryezat tematike, ekspertët prezantojnë gjetjet e analizës paraprake

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit gjatë muajit dhjetor përmbylli fazën e parë të konsultimit publik me zhvillimin edhe të 2 tryezave të tjera publike. Gjatë muajve nëntor–dhjetor 2024 janë zhvilluar 11 tryeza publike konsultimi me rreth 600 pjesëmarrës nga të gjitha grupet e interesit, institucionet shtetërore qendrore e vendore, institucionet e pavarura, agjencitë e ndryshme, komunitetin dhe shoqatat e biznesit, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare që operojnë në vend, shoqëri civile, profesorë të fakulteteve, ekspertë të pavarur etj. Gjatë zhvillimit të tryezave publike janë bërë një sërë komentesh, sugjerimesh dhe vërejtjesh tepër të vlefshme, të cilat do të shërbejnë në përmirësimin e dokumentit të analizës nga ekspertët e nivelit të lartë sipas shtyllave që mbulojnë.

6 dhjetor 2024

Tryeza me temë “Qeverisja e hapur”, organizuar në kuadër të shtyllës së mirë qeverisjes

Në këtë tryezë, e cila u moderua nga prof. dr. Eralda Methasani, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, u diskutuan gjetjet dhe sugjerimet e ekspertëve

lidhur me problematikat që shfaq llogaridhënia e institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor, si dhe u propozuan një sërë masash konkrete të nevojshme për rritjen e transparencës, si një nga elementet kryesore që ndikon në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj administratës publike, por dhe si mekanizëm për të forcuar përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e organeve publike.

Doc. Klesta Hysi, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, bëri prezantimin e gjetjeve kryesore të analizës së ekspertëve lidhur me transparencën e administratës publike. Ekspertët vlerësuan se parashikimet kushtetuese dhe ligji për të drejtën e informimit dhe ndryshimet e tij në vitin 2023 si dhe legjislacioni për procesin e konsultimit publik janë në përputhje me standardet europiane. Prof. dr. Migena Leskoviku, përgjegjëse e Departamentit të Legjislacionit dhe Politikës së BE-së në Institutin e Studimeve Europiane, Universiteti i Tiranës, bëri një përmbledhje të gjetjeve kryesore të analizës lidhur me llogaridhënien e institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor.

Pavarësisht arritjeve të konsiderueshme, ekspertët evidentuan disa problematika si: mungesa ndërgjegjësimit të administratës për të publikuar në mënyrë proaktive informacionin me karakter publik; programet e transparencës; vështirësi në realizimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik nga ana e Këshillave Bashkiak; probleme me transparencën e qeverisjes vendore, pasi për vitin 2023 rezultoi se vetëm 21 njësi të vetëqeverisjes vendore janë klasifikuar me transparencë proaktive të lartë etj.

10 dhjetor 2024

Tryeza me temë “Parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit në sektorët me risk të lartë në qeverisjen qendrore dhe vendore”, organizuar në kuadër të shtyllës së antikorrupsionit

Kjo tryezë u moderua nga prof. asoc. dr. Jonida Rystemaj, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Në të u diskutuan gjetjet kryesore, arritjet dhe problematikat e evidentuara nga ekspertët e nivelit të lartë lidhur me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në sektorët me risk më të lartë, si: prokurimet publike, PPP-të dhe koncesionet, investimet strategjike, tatimet, doganat etj.

Ekspertët vlerësuan se sektori i tatimeve dhe doganave janë sektorë të vlerësuar me risk në kuadër të luftës kundër korrupsionit, pavarësisht një sërë masash të ndërmarra, që lidhen me digjitalizimin e shërbimeve tatimore dhe doganore, sistemin e fiskalizimit, deklaramit të pronarëve përfitues, zbatimin efektiv të standardeve të kontabilitetit financiar në përputhje me standardin global të OECD-së etj. Në kuadër të parandalimit të korrupsionit në sektorin e tatimeve ekspertët theksuan nevojën e miratimit të rregullores së brendshme për hetimin administrativ të sinjalizimeve dhe ruajtjen e konfidencialitetit si dhe rregulloren që ndjek procesin e deklaramit të interesave private për punonjësit në bashkëpunim me ILDKPKI-në. Ekspertët theksuan gjithashtu se në sektorin e tatimeve, në qeverisjen qendrore dhe atë vendore është i nevojshëm harmonizimi i plotë i akteve ligjore me *acquis* të BE-së dhe standardet ndërkombëtare. Gjithashtu duhet të shihet me prioritet rritja e efikasitetit të kontrolleve dhe procedurave për përzgjedhjen e subjekteve për inspektime, por

dhe rritja e kapaciteteve dhe mekanizmave për hetime më efektive të rasteve të korrupsionit.

Një nga problematikat e hasura nga ekspertët është progresi i kufizuar në përafrimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik me *acquis* të BE-së, gjë për të cilën ekspertët rekomandun përsheptimin e punës për harmonizimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor për prokurimin publik me direktivat e BE-së, me qëllim përputhjen me standardet europiane, si dhe përmirësimin e efikasitetit dhe të transparencës në sistemin e prokurimit publik. Një tjetër problematikë e evidentuar nga ekspertët është lejimi i institucioneve qendrore që të negociojnë drejtpërdrejt dhe të lidhin marrëveshje konsulce me subjekte ndërkombëtare në fusha me interes strategjik, duke i përjashtuar ato nga procedurat konkurruese. Problematikë tjetër e konstatuar nga ekspertët është edhe përafrimi më tej i kuadrit ligjor me *acquis* të BE-së në fushën e koncesioneve dhe të partneritetit publik-privat. Sipas ekspertëve, ligji i ri për koncesionet dhe PPP-të duhet të ofrojë procedura të qarta dhe transparente për trajtimin e tyre; të përcaktojë në mënyrë të detajuar ndarjen e rreziqeve operative ndërmjet sektorit publik dhe atij privat; të përcaktojë qartë fushën e zbatimit të ligjit, përfshirë llojet e projekteve dhe të shërbimeve që përfshihen në koncesione dhe PPP.

Ekspertët theksuan se ligji për investimet strategjike, i miratuar në vitin 2015 për të promovuar investimet e brendshme dhe të huaja në sektorë strategjikë, nuk arriti të tërheqë investime të rëndësishme të huaja, megjithëse afati i ligjit është zgjatur disa herë. Shumica e projekteve të miratuara janë përqendruar në sektorin e turizmit dhe dominohen nga investitorë vendas. Në këtë kuadër ekspertët rekomanduan përmirësimin e kuadrit ligjor për investimet strategjike, publikimin e Regjistrit të Investimeve Strategjike, monitorimin dhe vlerësimin periodik të investimeve strategjike etj.

FORUMET E DIALOGUT ME QYTETARËT

Pas tryezave tematike të organizuara në Kryesinë e Kuvendit procesi i konsultimit publik do të vijojë edhe me forumet e dialogut qytetar në rrethe dhe kryesisht në mjediset universitare (universitetet publike dhe private). Në to do të ftohen të marrin pjesë pedagogë, studentë, përfaqësues të organizatave vendore të shoqërisë civile, të komunitetit të biznesit dhe të institucioneve të qeverisjes vendore si dhe qytetarë të interesuar për këto çështje.

12 dhjetor 2024

Nisën në Durrës forumet e dialogut me qytetarët, debatohen gjetjet dhe sugjerimet e ekspertëve për mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimin e ligjit

Procesi i konsultimit publik me qytetarët dhe grupet e interesit nisi në Universitetin "Aleksandër Moisiu" të qytetit të Durrësit nga znj. Milva Ekonomi, anëtare e Komisionit të Posaçëm për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit. E shoqëruar

nga anëtarë të Sekretariatit Teknik, znj. Ekonomi zhvilloi një takim me pedagogë dhe studentë të këtij Universiteti, ku bëri një përmbledhje të objektit, fushës së veprimit, instrumenteve dhe mekanizmave të funksionimit të Komisionit të Posaçëm në funksion të procesit të integritetit evropian të vendit.

Gjatë bisedës znj. Ekonomi i njohu të pranishmit me disa nga gjetjet e ekspertëve të atashuar pranë Komisionit të Posaçëm lidhur me situatën aktuale për çështjet e mirëqeverisjes, antikorrupsionit dhe sundimit të ligjit. Ajo nënvizoi rëndësinë e gjithëpërfshirjes së gjithë shoqërisë në këtë proces dhe u ndal në transparencën e reformës në administratën publike, në efektshmërinë dhe integritetin e administratës publike, llogaridhënien e institucioneve të pushtetit qendror dhe vendore, ofrimin e shërbimeve të digjitalizuara dhe mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve, efektivitetin dhe transparencën në menaxhimin e financave publike.

Të pranishmit bënë pyetje lidhur me disa teza për debat publik, si: zgjidhjet për qasjen më të lehtë ndaj teknologjisë për të gjitha moshat, mbrojtjen e të dhënave personale, zbatimin e Planit të Veprimit si dhe angazhimin e vazhdueshëm të profesionistëve në këtë proces të rëndësishëm për Shqipërinë.

18 dhjetor 2024

Konsultimi i Dokumentit Analitik, studentë dhe pedagogë të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan diskutuan për mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimin e ligjit

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan ishte ndalesa e radhës e konsultimit publik me qytetarët në kuadër të forumeve të dialogut me qytetarët dhe grupet e interesit për konsultimin e draftit të përgatitur nga ekspertët e nivelit të lartë të atashuar pranë Komisionit të Posaçëm për finalizimin e Dokumentit Analitik mbi situatën aktuale në fushën e mirëqeverisjes, antikorrupsionit dhe sundimit të ligjit.

Në takimin e organizuar me studentë dhe pedagogë të Fakultetit të Biznesit dhe të Drejtësisë të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit anëtarja e Komisionit të Posaçëm Evis Kushi i njohu të pranishmit me gjetjet kryesore, arritjet dhe problematikat e evidentuara nga analiza e bërë nga ekspertët e nivelit të lartë për tri shtyllat objekt pune të Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

Prof. dr. Migena Leskoviku, përgjegjëse e Departamentit të Legjislacionit dhe Politikës së BE-së në Institutin e Studimeve Europiane, Universiteti i Tiranës, bëri një përmbledhje të analizës rreth çështjeve lidhur me transparencën në reformën e administratës publike, efektshmërinë dhe integritetin e administratës publike, llogaridhënien e institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor, ofrimin e shërbimeve të digjitalizuara për qytetarët, efektivitetin dhe transparencën në menaxhimin e financave publike.

Prof. dr. Nada Dollani, përfaqësuese e qendrës “ALTRI”, bëri një prezantim të gjetjeve të ekspertëve të angazhuar në shtyllën e antikorrupsionit lidhur me parandalimin

dhe luftën kundër korrupsionit politik; parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në sektorët me risk më të lartë ndaj korrupsionit në qeverisjen qendrore dhe vendore; funksionimin dhe eficiencën e institucioneve që luftojnë korrupsionin, konfliktin e interesit dhe abuzimin me financat publike; parandalimin e financimeve të paligjshme dhe pastrimin e parave; ndërtimin e një shoqërie me integritet.

Më pas biseda u përqendrua në tezat për diskutim publik, ku të pranishmit bënë sugjerime konkrete lidhur me nevojën për ndryshime në ligjin 48/2014 “Për të drejtën tregtare” dhe përshtatjen e tij me direktivat e BE-së, për përmirësimin e cilësisë së relacioneve që shoqërojnë projektligjet, adresimin e vendimmarrjeve të GJEDNJ-së në ndryshime ligjore, nevojën për përfshirjen në kurrikulat arsimore të çështjeve të integritetit, nevojën e edukimit ligjor, gjetjen e mekanizmave dhe mesazheve sa më të qarta për t’i afruar dhe përfshirë qytetarët dhe grupet e interesit në proceset reformuese që do kalojë shoqëria në kuadër të integritetit të vendit në BE etj.

Anëtarja e Komisionit të Posaçëm Milva Ekonomi, pasi i informoi studentët dhe pedagogët për forumet e dialogut me qytetarët dhe fazat e punës së Komisionit, nënvizoi rëndësinë e gjithëpërfshirjes së shoqërisë në proces për të garantuar rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe ofrimit të shërbimeve për të garantuar standardet europiane. Anëtarja e Komisionit të Posaçëm Etilda Gjonaj theksoi rëndësinë e rritjes së ndërgjegjësimit të qytetarëve për të forcuar mekanizmat sinjalizues dhe denoncues për rastet e korrupsionit, nxitjen e modeleve pozitive të integritetit dhe i ftoi të rinjtë të jenë aktorë dhe kontribues në proceset integruese.

Në përfundim të takimit znj. Evis Kushi, pasi i falënderoi pjesëmarrësit për bashkëbisedimin, i ftoi ata të bëhen pjesë e dialogut interaktiv me ekspertët nëpërmjet faqes së Komisionit të Posaçëm.

18 dhjetor 2024

Forumet e dialogut me qytetarët, mbahet takimi në Vlorë për mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimin e ligjit

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit zhvilloi në Universitetin “Ismail Qemali” të Vlorës forumin e tretë të dialogut me qytetarët dhe grupet e interesit për konsultimin e draftit të Dokumentit Analitik me arritjet, gjetjet dhe rekomandimet e dala nga grupet e ekspertëve për tri shtyllat. Prof. dr. Migena Leskoviku bëri prezantimin në emër të grupit të ekspertëve të shtyllës së mirëqeverisjes, ku theksoi rëndësinë e reformave për të ndërtuar institucione sa më efektive, të përgjegjshme dhe transparente, që mund të mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm dhe shtetin e së drejtës në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësim në BE. Qeverisja e hapur konsiderohet si një kulturë qeverisjeje e bazuar në politika dhe praktika publike inovative dhe të qëndrueshme, të frymëzuara nga parimet e transparencës, integritetit, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes që nxit demokracinë dhe rritjen gjithëpërfshirëse.

Për shtyllën e antikorrupsionit prezantimin e gjetjeve e bëri prof. dr. Nada Dollani, e cila u ndal në pesë komponentët e kësaj shtylle: i) parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit politik; ii) parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit në administratën qendrore dhe vendore, me fokus në sektorët me risk të lartë; iii) funksionimi dhe efienca e institucioneve që luftojnë korrupsionin, konfliktin e interesit dhe abuzimin me financat publike; iv) parandalimi i financimeve të paligjshme dhe pastrimit të parave; v) ndërtimi i një shoqërie me integritet. Pas prezantimit të gjetjeve nga ekspertja dhe rekomandimeve kryesore, u trajtuan edhe tezat kryesore për konsultim publik të kësaj shtylle.

Anëtarja e Komisionit të Posaçëm Milva Ekonomi bëri një përmbledhje të punës së Komisionit të Posaçëm. Ajo foli për rëndësinë e nisjes së një procesi të thellë reformimi për të përgatitur shoqërinë për procesin integritet në BE, forumet e dialogut me qytetarët për paraqitjen e draftit të Dokumentit Analitik, i cili do të konsultohet edhe me ekspertë shqiptarë e të huaj dhe me institucione ndërkombëtare.

Më pas, përmes një bashkëbisedimi me të pranishmit, grupi i ekspertëve dhe znj. Ekonomi iu përgjigjën pyetjeve dhe komenteve të bëra nga audienca, duke e konsideruar me rëndësi këtë proces të konsultimit me grupet e interesit dhe për efekt të ndërgjegjësimit lidhur me misionin dhe rëndësinë e punës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar në kuadër të rritjes së fokusit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në përshpejtimin e procesit të anëtarësimit në BE, përmirësimin e mëtejshëm dhe konsolidimit të praktikave të mirëqeverisjes në të gjitha nivelet, fuqizimin e luftës kundër korrupsionit dhe forcimin e shtetit të së drejtës.

17 dhjetor 2024

Komisioni i Posaçëm zhvillon mbledhjen e rradhës, miratohen 3 vendime

Pas miratimit të procesverbalit të mbledhjes së mëparshme, kryetari i Komisionit të Posaçëm, z. Xhafaj, informoi mbi procesin e analizës së bërë për komponentin 3 – shtylla III, “Konsolidimi i Reformës në Drejtësi”. Duke nënvizuar se rezoluta e Kuvendit e miratuar më 27 maj 2024 konfirmon pakthyeshmërinë e reformës në drejtësi dhe konsolidimin e saj të mëtejshëm dhe domosdoshmërinë e rritjes së eficiencës së sistemit të drejtësisë në pritshmëritë e qytetarëve shqiptarë, z. Xhafaj informoi se draftstruktura e dokumentit analitik për komponentin 3, “Konsolidimi i drejtësisë”, i shtyllës III, “Sundimi i ligjit”, është konsultuar me Grupin e Ekspertëve të Nivelit të Lartë, por dhe me misionet e asistencës ndërkombëtare që monitorojnë, asistojnë dhe mbështesin sistemin e drejtësisë.

Z. Xhafaj nënvizoi se procesi i analizës dhe planit të veprimit është i domosdoshëm për tri arsye themelore: i) për të reflektuar gjetjet, problematikat dhe rekomandimet e dhëna në këtë fushë nga raportet e BE-së; ii) kryerjen e kontrollit postlegjislativ në zbatim të rolit kushtetues të Kuvendit dhe përcaktimeve të bëra në Rregulloren e tij, por dhe bazuar në përvojën më të mirë ndërkombëtare të kësaj fushe; iii) për adresimin e amendamenteve të paraqitura që prej vitit 2022 dhe në vijim nga vetë institucionet e drejtësisë.

Komisioni më pas miratoi përbërjen e grupit të punës të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Sekretariatit Teknik, konsulentët e huaj ndërkombëtarë, shtetas të huaj dhe shtetas shqiptarë që kontribuojnë jashtë vendit (pedagogë, kërkues shkencorë, gjyqtarë, prokurorë, avokatë etj.) si dhe përfaqësuesit e ekspertizës ndërkombëtare që do të asistojnë e monitorojnë procesin edhe në këtë fushë përmes projekteve përkatëse të Delegacionit të BE-së dhe ambasadës së SHBA-ve (OPDAT), si dhe ekspertëve nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Banka Botërore, ambasada Franceze etj.

Më pas deputetja Milva Ekonomi, anëtare e Komisionit të Posaçëm, bëri një prezantim të metodologjisë së procesit për përgatitjen e Planit Kombëtar të Veprimit dhe qasjes ndaj këtij dokumenti. Znj. Ekonomi informoi se për formatin e Planit Kombëtar të Veprimit është marrë ekspertiza ndërkombëtare, një ekspert me përvojë, ofruar nga ambasada zviceriane, si dhe ekspertizë vendase nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë. Formatin u miratua parimisht, por do të jetë i hapur për përmirësim edhe me procesin e konsultimit që do të kryhet edhe me ekspertizën ndërkombëtare dhe Kryenegociatoren.

Komisioni miratoi ndryshimet në organigramën, strukturën dhe përbërjen e GENL-së dhe Sekretariatit Teknik, si dhe informoi mbi raportin e pagesës së ekspertëve të miratuar nga Byroja e Kuvendit me vendimin nr. 95/2024. "Fondi i përllogaritur në total për vitin 2024 është rreth 35 milionë lekë, që është brenda fondeve të miratuara nga Kuvendi. Pagesa maksimale për një ekspert nuk e kalon vlerën bruto 550 mijë lekë dhe këta janë vetëm 30% e numrit të ekspertëve, të cilët janë kategorizuar në 3 kategori, në varësi të kohës dhe produkteve që kanë dhënë", – sqaroi z. Xhafaj.

Përfaqësuesit e opozitës në Komision nuk morën pjesë në mbledhje.

Takime pune me ekspertët e GENL-së dhe anëtarët e Sekretariatit Teknik

Kryetari i Komisionit të Posaçëm Parlamentar zhvilloi një takim me ekspertët e nivelit të lartë që po punojnë për reflektimin në draftin e Dokumentit Analitik të komenteve të ndryshme që janë bërë në 11 tryezat tematike, opinionet e dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë dhe të dërguara nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile etj.

Në këtë takim deputetja Ekonomi, anëtare e KPP-së, prezantoi një konceptide lidhur me formatin mbi të cilin do të ndërtohet Plani Kombëtar i Veprimit (PKV), dokument i cili është hartuar me asistencën e ekspertit me përvojë në BE të kontraktuar nga GPG-ja me mbështetjen e projektit të qeverisë zvicerane, projekt që ofron asistencë teknike për Kuvendin. Rreth këtij procesi u bë një debat i hapur lidhur me formën e prezantimit, reflektimin e dokumenteve dhe strategjive të ndryshme të miratuara nga qeveria, angazhimeve të marra nga shteti shqiptar përmes tyre si dhe akteve të tjera të dakordësuara me BE-në, procesin e konsultimit publik, narrativën publike në raport me interesin e qytetarëve dhe grupet e interesit etj.

Kryetari i Komisionit të Posaçëm Parlamentar zhvilloi një takim tjetër me ekspertët e GENL-së dhe anëtarët e Sekretariatit Teknik të angazhuar për hartimin e Dokumentit

Analitik dhe të Planit të Veprimit për shtyllën III – komponentin 3, “Konsolidimi i sistemit të drejtësisë”. Në takim u shkëmbyen mendime dhe u përcaktuan detyrat lidhur me organizimin e punës, procesin që do të ndërtohet si dhe afatet përkatëse për përmbushjen e detyrave të caktuara.

Një takim me interes ishte edhe ai i zhvilluar me ekspertë dhe përfaqësues të institucioneve dhe organizatave të sistemit të drejtësisë për t’i njohur me qasjen dhe metodologjinë e procesit, me dokumentet mbi të cilat po punon Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, organizimin e tyre, afatet e përcaktuara si dhe mundësinë për përfshirjen e kontributeve aktive të institucioneve të drejtësisë etj.

Çfarë pritet të ndodhë gjatë muajit janar 2025 me agjendën e Komisionit?

Gjatë muajit janar nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariati Teknik do të përmbillet hartimi i Dokumentit Analitik dhe miratimi i tij nga Komisioni i Posaçëm për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit.

Janë programuar të zhvillohen disa tryeza tematike në Tiranë me grupe të veçata interesi, si: me organizatat kryesore të komunitetit të biznesit, me përfaqësues të organizatave të qeverisjes vendore, me pedagogë dhe studentë të Shkollës së Magjistraturës, me prokurorë, gjyqtarë dhe avokatë etj. Gjithashtu Komisioni i Posaçëm bashkë me ekspertët e nivelit të lartë do të vijoje organizimin e gorumeve të dialogut me qytetarët në qytete të tjera të vendit dhe kryesisht në mjediset universitare.

Në këto tryeza tematike dhe në forumet e dialogut qytetar do të diskutohen gjetjet e analizës paraprake të ekspertëve në Dokumentin Analitik dhe veçanërisht zgjidhjet dhe propozimet kryesore që mendohet të jenë pjesë e Planit Kombëtar të Veprimit. Paralelisht me këtë proces gjatë muajit janar do të punohet për të hartuar edhe draftin e parë të Planit Kombëtar të Veprimit, formati i të cilit është miratuar tashmë me vendim të Komisionit dhe për të cilin janë angazhuar kapacitetet e ekspertëve më të mirë të atashuar pranë Komisionit të Posaçëm për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar



KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

**“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN PËR
SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**